

# NEWSLETTER

Gusht

Albsig  
Nuk Le Asnjë  
Dëm “Pezull”

Ndërtuesit  
Gjejnë Sigurinë  
Vetëm në Albsig



Pushimet Verore,  
Pajisuni me Sigurimin e  
Shëndetit në Udhëtim

Shqiptarët ia  
Besojnë Sigurimin  
e Shëndetit Albsig

Shqiptarët ia  
Besojnë Sigurimin  
“Kasko” Vetëm Albsig

Albsig Fushatë  
Sensibilizuese për  
Një të Ardhme  
më të Sigurt

Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë,  
Hap Dyert Këtë Vit

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

#### **VIZIONI**

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

#### **MISIONI**

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

#### **FILOZOFIA**

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



# Bli Online

## albsig.al





# D  MET “PEZULI”

# Albsig Nuk Le Asnjë Dëm “Pezull”

Dëmshpërblimi në kohë dhe kundrejt procedurave të rregullta dhe në favor të klientit, ndonëse një proces i munguar, për ALBSIG prej më shumë se pesë vitesh vlerësohet si një çështje që ka marrë një zgjidhje të plotë dhe përfundimtare. Të gjitha procedurat e ndjekura nga kompania, janë totalisht transparente dhe favorizojnë klientin.

Statistikat tregojnë se ky proces ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e kënaqësisë së klientëve, zgjerimin e bazës së klientëve besnikë dhe rritjen e numrit të klientëve për të gjitha kategoritë e produkteve dhe shërbimeve. Periudha e ekzekutimit dhe mbylljes së procedurave të dëmeve të vogla është minimalisht 3 ditë, ndërsa për dëmet e tjera me vlera të konsiderueshme, periudha e ekzekutimit dhe mbylljes së çështjes shkon mesatarisht 30 ditë.



30.06.2021



30.06.2022

Në buletin zyrtar të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për periudhën Janar-Qershor, dëmet pezull (të papaguara) të Albsig, kanë numrin më të vogël në treg. Konkretisht, numri i dosjeve të tilla nga data 30.06.2021 deri më 30.06.2022 ka ulje të konsiderueshme nga 289 në 191 dosje. Pra në numër janë më pak se 98 dosje dhe në vlerë 21.35%, zë ky që e evidenton në mënyrën më transparente dhe të mundshme pagesën në kohë rekord të dosjeve të tilla. Aktualisht, Albsig kryeson tregun me dëmshpërblimet njëkohësisht radhitet e para për Sigurimin Kasko dhe e dyta për Sigurimet Vullnetare dhe ky sigurisht është tregues shumë i madh i besimit të klientëve që sa vjen e rrënjohet në këtë kompani.

Nuk duhet të harrohet fakti që konkurrenca në tregun e sigurimeve është shumë e madhe dhe herë-herë e pakontrolluar, sidomos përsa i përket grupit të produkteve vullnetare. Megjithatë, në vite duket se Albsig ia ka dalë që të ruajë trendin në rritje dhe të shtojë numrin e klientëve. Kultura korporative dhe modeli i biznesit që Albsig aplikon si pjesë e Grupit Kastrati, e lejon që të ketë avantazhe të shumta, të tilla si reagimi dhe përshtatja e shpejtë ndaj ndryshimeve në treg dhe gjithashtu i mundëson që të ketë rolin kryesor në cilësinë e shërbimeve që Albsig u ofron klientëve të saj. Të qenurit pjesë e një prej grupeve më të mëdhenj dhe më të suksesshëm në Shqipëri dhe rajon siç është Kastrati Group rrjedhimisht ofron më shumë siguri dhe më shumë përfitime për klientët e saj.

# Shqiptarët ia Besojnë Sigurimin e Shëndetit Albsig

Shqiptarët edhe pse janë futur në vitin e tretë të pandemisë, përsëri tregojnë se janë një popull paksa neglizhent, jo vetëm ndaj kujdesit shëndetësor, por edhe ndaj masave për sigurimin e tij.

Këtë fakt e tregojnë me detaje të hollësishme të dhënat për Sigurimin mbi Shëndetin në buletin zyrtar statistikor të AMF, për të cilin Shqipëria është thuajse e fundit në Evropë. Mungesa e edukimit mbi sigurimet dhe rëndësia e sigurimit të shëndetit privat, ka bërë që një pjesë e shqiptarëve të mjaftohen me sigurimet e detyruara shëndetësore në shtet, në një kohë që një pjesë e madhe as për këto nuk interesohen. Nga ana tjetër, në Shqipëri edhe vet shteti megjithëse paguhet nga kontribuentët vendas, u ofron atyre vetëm një pjesë të shërbimeve shëndetësore nëpër spitalet publike, edhe këtë me mjaft mangësi. Prandaj, Albsig ju mundëson paketat shëndetësore, të cilat mbulojnë shpenzimet spitalore në rast aksidenti apo sëmundjeje, si edhe shpenzimet jashtë spitalore të rekomanduara nga mjeku.

Zgjidh mes paketave shëndetësore të Albsig, atë që ju përshtatet më së miri. Me Kartat e Shëndetit Albsig, që ju do të përzgjidhni do përfitoni shërbim mjekësor në kohë rekord në spitalet apo klinikat e dëshiruara, pa procedura burokratike. Policat e Sigurimit Shëndetësor Albsig, janë krijuar për t'iu përshtatur çdo kategorie dhe nevojë, duke ju ofruar mbulim për trajtime mjekësore dhe kujdes parandalues. Është e domosdoshme të kujdeseni për veten tuaj, familjen, apo edhe për stafin e biznesit tuaj. Me rritjen e kostove të shtrimit në spital dhe trajtimit mjekësor, të kesh një policë sigurimi shëndetësor është thelbësore. Jo vetëm që ju lehtëson barrën financiare, por gjithashtu ju jep akses në qendrat spitalore më cilësore të kujdesit shëndetësor në të gjithë vendin, apo edhe jashtë tij. Sipas statistikave të AMF për muajt Janar-Qershor 2022, Albsig për Sigurimin nga Sëmundjet, zë vendin e dytë, me 19.36% të tregut dhe me një rritje me veten më të madhe se 86.47%.

## Shëndeti i shqiptarëve, në varësi të rryshfeteve e xhepave

Në Shqipëri, shërbimi shëndetësor “falas për të gjithë” është ende një ëndërr. Sistemi i sigurimeve të detyrueshme shëndetësore ofron zyrtarisht falas shumicën e shërbimeve, nëse pacienti ndjek një sistem të caktuar reference. Por, për shkak të cilësisë së dobët të shërbimit, mungesës së stafi të specializuar jashtë qendrave të mëdha urbane, korrupsionit dhe kapaciteteve të pamjaftueshme për shërbime të veçanta, shpeshherë pacientët detyrohen t'i marrin pranë qendrave shëndetësore private. Shërbimet spitalore hasin shpesh mungesë të barnave të domosdoshme, që jo rrallë të sëmurët detyrohen t'i sigurojnë dhe t'i paguajnë vetë nga xhepi i tyre. Për të sëmurët kronik ose ata që diagnostikohen me kancer, mungesa e medikamenteve është thuajse e përvitshme. Të dhënat e Bankës Botërore e rendisin Shqipërinë si një ndër vendet me pagesat më të larta nga xhepi i qytetarëve për shërbimet shëndetësore jo cilësore, me rreth 50% të shpenzimeve totale. Por, shembulli më i fundit është pandemia e Covid-19, ku pacientët që trajtohen në kushte shtëpie, janë të detyruar të paguajnë vetë të gjithë koston e barnave dhe kurave të tjera. Ndërsa në Evropë, një pjesë e mirë e nevojave për kujdes shëndetësor mbulohen nga skemat private të sigurimeve.

## Sigurimi i shëndetit edhe pse detyrim mbetet ende një luks

Tërmetet e fundvitit 2019 dhe pandemia e Covid-19 sollën një frymë të re ndërgjegjësuere për tregun e sigurimeve. Kjo frymë e re ndikoi ndjeshëm sidomos në produktet e sigurimit të pronës dhe të shëndetit. Pandemia Covid-19 futi një frymë ndërgjegjësimi të një pjesë e konsiderueshme e konsumatorëve, sidomos për Sigurimin e Shëndetit Privat. Përvojat e mëparshme me këto produkte dhe frika nga pandemia bëri që një pjesë e mirë e konsumatorëve të ndërgjegjësohen dhe të pajisen me Sigurimet Shëndetësore për vete dhe familjet e tyre. Familjet e nivelit mbi mesataren, të trembur sidomos nga pandemia e stërzgatur e Covid-19, kanë nisur që të shqetësohen më tepër për shëndetin e tyre, prandaj u janë drejtuar edhe skemave private të Sigurimit Shëndetësor. Për gjashtë mujorin e parë të këtij viti, shqiptarët kanë shpenzuar **453,540/000 milion** lekë për Sigurimin Privat të Shëndetit krahasuar me po të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ku kjo shumë ishte **430,512/000 milion lekë**, duke u rritur me 5,35% këtë produkt në treg. Të dhënat nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, tregojnë një rritje të primeve në këtë klasë sigurimi me 5.35%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky është një ndër produktet e pakta të sigurimit që paraqiten në rritje këtë vit, por vlerat ngelen tejet modeste, ashtu si gjithë tregu i sigurimeve vullnetare në përgjithësi.





Një Partner  
me Përvojë  
në Anën Tuaj!

ALBSIG Jeta



# Shqiptarët ia Besojnë Sigurimin “Kasko” Vetëm Albsig

Shqiptarët ja besojnë sigurinë e makinave vetëm Albsig dhe për të gjithë të apasionuarit e automjeteve, Albsig ju vjen në ndihmë në çdo moment. Sipas statistikave të AMF, Kompania e Sigurimeve Albsig sh.a. është cilësuar lider në treg, për Sigurimin Vullnetar Kasko. Sigurimi Kasko për muajt Janar-Qershor të vitit 2022 zë vendin e parë në treg me 35.44% dhe është në mënyrë të vazhdueshme në rritje progresive me një diferencë të lartë me vendin e dytë me vlerë 75.957lekë/000.

Duke u bazuar në statistikën e AMF, e thënë ndryshe, ALBSIG nuk ofron thjesht produkte dhe shërbime, por kujdeset në çdo detaj për klientët e saj. Ajo që e diferencon kompaninë Albsig në treg, është pikërisht cilësia e produkteve dhe shërbimeve të ofruara pasi shifrat në rritje muaj pas muaji e bëjnë dhe më të dukshme arritjen e shoqërisë. Rritja e vazhdueshme dhe konsolidimi i pozitave në tregun e sigurimeve, sigurisht i kanë dhënë Albsig-ut mundësinë që të jetë edhe më optimiste për t'u bërë zgjedhja e parë e shqiptarëve në çdo sektor ku Albsig operon duke ju dhënë vlerë shërbimeve që ofron. E thënë ndryshe, ALBSIG dhe të gjitha kompanitë e Grupit Kastrati, nuk ofrojnë thjesht produkte dhe shërbime, por kujdesen për klientët e tyre.

## Albsig Kasko edhe për territorin jashtë Shqipërie

Çdo qytetar shqiptar që jeton në Kosovë dhe e anasjellta, tani e tutje do të kenë mundësi të pajisin automjetin e tyre me sigurimin Kasko në Albsig.

Pajisja me Full Kasko në Albsig bën që klienti të përfitojë dëmshpërblim për dëmtimin e mjetit në territorin e Shqipërisë si dhe në territorin e Kosovës, pa kosto shtesë për dëmin e ndodhur jashtë, njëkohësisht duke përfshirë të gjitha mbulimet që klienti ka për zgjedhur me dëshirën e tij dhe sipas standardit të vendosur nga kompania.

Në rast dëmi, me paraqitjen e kërkesës për dëmshpërblim, Albsig sh.a. ju paguan brenda 7 ditë pune nga plotësimi i praktikës së dëmit me dokumentacionin e nevojshëm. Klienti mund të zgjedhë nëse dëshiron ta marrë pagesën e dëmit cash apo të riparojë mjetin e dëmtuar, pranë serviseve dhe koncesionarëve më të specializuar në vend.

## Nevoja për pajisjen e mjetit me Sigurimin Kasko

Të kesh një automjet në kohët e sotme është një nga investimet kryesore për Ju dhe Familjen Tuaj. Automjeti është pjesë e pandashme e çdonjërit prej nesh. Për këtë është e nevojshme ta pajisni makinën me Sigurimin Kasko për të përfituar sa më shumë siguri dhe jetëgjatësi.

Në rast se Ju jeni shkaktar i një aksidenti në trafik, sigurimi i detyrueshëm TPL nuk ofron dëmshpërblim për automjetin tuaj, por vetëm për automjetin që ju keni dëmtuar. Që të mos endeni dyerve të serviseve e koncesionarëve, mjafton ta blini Sigurimin Kasko dhe aty do të përfitoni shërbimin e dëshiruar. Rritja e shërbimeve të shpejta, seriozitetit dhe çmimeve konkurruese në treg ka bërë që kompanitë e sigurimeve të perfeksionojnë produktet e tyre rreth sigurimit të mjeteve motorike.



# Sigurimi Kasko

# -10%

për blerjet online




ALBSIG



PJESË E  
KASTRATI GROUP

# Ndërtuesit Gjejnë Sigurinë Vetëm në Albsig



## Ndërtime të reja dhe të sigurt, apartamente banimi të siguruara për gjithë jetën.

Ndërgjegjësohen ndërtuesit, investojnë në sigurinë e ndërtimeve që bëjnë. Që pas dy tërmeteve të vitit të shkuar, puna e ndërtuesve sa vjen e ndërgjegjësohet dhe vështirësohet. Përveç rregullave strikte që janë vendosur tashmë, për ndërtimet e reja dhe ato në vazhdim është shtuar edhe sigurimi i përgjegjësisë në ndërtim. Bazuar në statistikën zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Albsig sh.a. tashmë ka mbi 52.79% të tregut për periudhën Janar-Qershor 2022 dhe për muajin Qershor kryeson vendin e parë me 46% të tregut. Shoqëria e Sigurimeve Albsig lider në treg për Sigurimin e Përgjegjësisë në Ndërtim, tashmë është partnerja kryesore e çdo ndërtuesi. Tani e tutje, ndërtuesit kanë gjetur sigurinë e ndërtimeve të tyre duke u bazuar në sigurimet e përgjegjësisë në Albsig. Marrëdhëniet korrekte me klientët, dëmshpërblimi në kohë rekord dhe kundrejt procedurave ligjore në rastet e dy tërmeteve, duket se kanë reflektuar në perfeksionimin dhe mbushjen e portofolit të Sigurimit të Përgjegjësisë së Ndërtuesit në Shoqërinë Albsig.



Sipas specialistëve të kësaj fushe, aktualisht praktika më e ndjekur nga ndërtuesit është sigurimi i pronave në momentin e përfundimit të objektit dhe aplikimit për marrjen e lejes së shfrytëzimit. Përgjithësisht, sigurimi bëhet për vlerën e kostos së ndërtimit, ç'ka në thelb bie ndesh me frymën e ligjit dhe VKM-së përkatëse, që kërkon sigurimin e pronës për vlerën e saj të tregut.

Rrjedhimisht, në pjesën më të madhe, kontratat e sigurimit të nënshkruara gjatë këtij viti përfaqësojnë numrin e pronave të përfunduara dhe të regjistruara nga ndërtuesit. Tashmë tregu i sigurimeve ofron Sigurimin e Përgjegjësisë së Ndërtuesit për të gjithë ndërtuesit, të cilët kërkojnë të pajisen me Certifikatën e Përdorimit për objektin e përfunduar ose kur bëhet kalimi i pronësisë nga ndërtuesi te blerësi. Ky sigurim është i detyrueshëm dhe mbulon dëmtime të ndodhura drejtpërdrejtë në ndërtesë si shembje tërësore, pjesore të ndërtesës ose rrezik i dukshëm për t'u shembur apo dëmtime të tjera në ndërtim.

Gjithashtu, Albsig me këtë sigurim dëmshpërblen dhe palën e tretë si dhe blerësin/përfituesin e pronës për dëmtime trupore apo humbje të jetës. Ajo që vlen për t'u theksuar është se tashmë jo vetëm pronarët fizik që disponojnë një apartament, por dhe ndërtuesit kanë mundësi të bëjnë sigurimin e pallateve. Sigurimi i Përgjegjësisë së Ndërtuesit konkretisht ka si objekt hipotekimin e pronës së blerë (apartament/banesë) prej gjithësecilit nga ne, në zbatim të VKM-së nr. 550 dt. 2 Tetor 2019. Nëse objekti dëmtohet si pasojë e një gabimi në mos zbatimin korrekt të projektit të ndërtimit, atëherë dëmet e shkaktuara do të paguhen nga kjo kontratë sigurimi. Çmimi i sigurimit, sipas VKM-së për një afat 10-vjeçar përlogaritet 1% e vlerës së shitjes së pronës.

Në mbështetje të ligjit "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", të ndryshuar me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave para 3-viteve vendosi që "ndërtuesi, zhvilluesi apo investitori i dorëzon blerësit, njëkohësisht me lidhjen e kontratës për kalimin e pronësisë së ndërtesës, një kontratë sigurimi me afat 10- (dhjetë-) vjeçar me përfitues blerësin apo blerësit dhe me efekt nga data e përfundimit të punimeve".

"Kjo kontratë sigurimi mbulon dëmet e ndërtesës, që shfaqen pas lidhjes së kontratës së kalimit të pronësisë, përfshirë dëmet ndaj të tretëve, që rrjedhin kur, për shkak të tokës ose për defekt të ndërtimit, ndërtimi shembet tërësisht ose pjesërisht, ose paraqet rrezik të dukshëm shembjeje ose defekte të tjera të rënda. Limiti i përgjegjësisë së kontratës së sigurimit nuk duhet të jetë më i ulët se vlera totale e çmimit të shitjes të përcaktuar në kontratën e kalimit të pronësisë së pasurisë së paluajtshme





Tarifa vjetore e primit të sigurimit nuk mund të jetë më e ulët se 0.1 (zero pikë një) për qind e shumës së sigurimit/limit të përgjegjësisë së përcaktuar në kontratën e sigurimit”, thuhet në vendimin e qeverisë. Gjithashtu në vendim saktësohet se “noterët lidhin kontratën për kalimin e pronësisë së ndërtesës nga ndërtuesi/zhvilluesi/investitori tek blerësi, shoqëruar me kontratën e sigurimit 10- (dhjetë-) vjeçar në favor të blerësit/blerësve të kryer nga shitësi, në përputhje me ligjin “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar, si dhe me ligjin “Për Noterinë”. “Kërkesa për regjistrim në regjistrin e pasurive të paluajtshme të kontratave të kalimit të pronësisë së ndërtesës nga ndërtuesi/zhvilluesi/investitori tek blerësi, shoqërohet edhe me kontratën e sigurimit 10- (dhjetë-) vjeçar në favor të blerësit/blerësve, të kryer nga ndërtuesi/zhvilluesi/investitori. Në rast mungese të kontratës së sigurimit, kërkesa për regjistrim të kontratës së kalimit të pronësisë nuk administrohet nga sporteli i shërbimeve kadastrale. Elementet dhe kushtet e përgjithshme të kontratës së sigurimit të detyrueshëm për t’u zbatuar nga shoqëritë e sigurimit miratohen nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare pas marrjes së mendimit nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe ministria përgjegjëse për financat”, sqarohet më tej në vendimin e Këshillit të Ministrave. Gjithësecili nga ne që është pronar i një apartamenti/banese të siguruar në shoqëritë e sigurimit dhe ka pësuar dëmtime nga tërmeti, mund të përfitojë kompensim, sipas ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit”. Polica e sigurimit u jep mundësinë qytetarëve që të sigurohen nga zjarri dhe forcat e natyrës në mënyrë vullnetare dhe çdo biznes apo rezident mund të kryejë sigurimin e pronës në një nga 8 shoqëritë e sigurimit të jo-jetës që ushtrojnë aktivitetin në Shqipëri. Në raportin mesatar 1 me 1000, pra një banesë me vlerë 100 mijë euro sigurohet për 100 euro/vit, siguri banesën.



## Noterët “dorzan” për sigurinë e ndërtuesve.

Vetëm përmes vulës së noterëve tashmë ndërtuesit do të vërtetojnë sigurinë e ndërtimeve për një periudhë 10-vjeçare. Sigurimi i përgjegjësisë së ndërtuesve edhe pse një siguri i duhur deri tani është menduar si diçka plotësuese dhe jo kryesuese. Por për noterët është një detyrim ligjor, i cili vetëm përmes tyre bën të mundur vërtetësinë e sigurisë së ndërtimeve. Në të gjithë vendin vetëm përmes noterizimit të procesit të sigurimit të përgjegjësisë së ndërtuesve bëhet i mundur dhe çlirimi i ndërtimit. “Ligji për sigurimin e ndërtimeve tashmë nuk është dëshirë e ndërtuesve, sepse është detyrim ligjor, je i detyruar të bësh pagesën. Kjo është shumë pozitive dhe në të mirë të personave që blejnë një shtëpi, sepse po ta lësh në dëshirë e qytetarit ndoshta nuk e bëjnë sigurimin e banesës. Kjo u pa edhe gjatë kohës së tërmetit, ku shumë njerëz nuk i kishin siguruar shtëpitë apo ndërtesat dhe nuk përfituan asgjë. Me këtë ligj, qytetari për 10 vjet e ka të siguruar, është një gjë shumë e mirë”, u shpreh Rovena Jakova, notere në qytetin e Durrësit.

# Pushimet Verore



## Sigurimi i Shëndetit në Udhëtim, Mbrojtja e Financave për Çdo Familje

Pas tre vite pauze, kanë mundur të sigurojnë pushimet jashtë Shqipërie. Meqë fëmijët janë në moshë ende të vogël, Turqia ka qenë dhe vendi i preferuar për ta. Kanë katër fëmijë dhe kanë qenë pushimet që kanë ëndërruar pas tre vite pauze. Bëhet fjalë për familjen Bislmi, ku, këto të fundit mundën të kalonin 7 ditë pushime në Antalya. Pushimet përgjithësisht i kaluan shumë mirë, por në fund patën një incident të vogël që falë Albsig çdo gjë mori zgjidhjen e duhur. “Fëmijët mezi e pritën sezonin e pushimeve dhe ne u përgatitëm për çdo gjë. Falë Zotit u pajisëm me sigurimet e duhura edhe pse në raste të tilla asnjëherë njeriu nuk e çon mendjen për të menduar për keq”, kështu nis e tregon Artur Bislmi për eksperiencën e tij jashtë Shqipërie.

Ai shton se së bashku me familjen kanë qenë të pajisur me Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim dhe ky sigurim ka qenë pasaportë sigurie për ta. Madje ai thekson se kur janë nisur e kanë blerë online Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim sepse kanë pas probleme me kohën e kufizuar. “Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim për të gjithë familjen e kemi blerë online. Vajzën e madhe e kam në klasë të shtatë, dy djemtë binjakë i kam në klasën e katër ndërsa të voglin e kam pesë vjeç. Vajza na e ka blerë online Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim dhe vetëm ditën e fundit kur po përmbyllim pushimet, djali i vogël pësoi një aksident në pishinën e hotelit. Falë Zotit djali me shpëtoi për mrekulli, por me aq sa kishte probleme, sapo morën vesh se ne kemi Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim çdo procedurë spitalore është zbatuar me përpikmëri”, vijon së treguari z. Bislmi. Ky i fundit shton se çdo procedurë spitalore është ndjekur me përpikmëri dhe jo vetëm kaq, por brenda ditës ka njoftuar dhe Albsigun për dëmin e ndodhur.

“Pasi bëra çdo procedurë atje në Turqi mora të gjitha faturat dhe bashkë me policën e sigurimit erdha në Albsig. Specialistët e Albsig më kanë pritur shumë mirë. Pasi ishin njohur me rastin, e shqyrtuan atë sipas politikave institucionale që ata kanë dhe më pas më treguan dhe vlerësimin e shumës së dëmit që ata e kishin konsideruar”, shtoi z. Bislmi. Ai udhëzon të gjithë konsumatorët që, jo vetëm ata që bëjnë pushime jashtë Shqipërie, por edhe ata që janë brenda vendit të pajisen me sigurimet e duhura. Pajisja me Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim është pasaporta e sigurisë së shëndetit për gjithësecilin prej nesh.



# Bregdet, Albsig Fushatë Sensibilizuese për Një të Ardhme më të Sigurt



Jemi gjithmonë pranë jush për ta bërë verën më të bukur dhe më të sigurt me Albsig.

Albsig këtë vërë ka zhvilluar një fushatë sensibilizuese për një të ardhme më të sigurt. Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group ka ofruar për pushuesit, jo vetëm informacione të nevojshme, por ka dhuruar edhe materiale promociionale argëtuese. Ka qenë bregdeti i jugut të Shqipërisë që një fundjavë është "veshur" me të kuqen e Albsig.

Një pjesë e mirë e pushuesve janë pajisur me materiale promociionale verore për fëmijë. Një sasi e konsiderueshme artikujsh promociionale dhe lodra për fëmijë siç janë: loja pingpong, çanta termike, peshqirë plazhi, frizbi, etj janë shpërndarë për pushuesit e bregdetit të jugut. Fushata sensibilizuese për një të ardhme të sigurt në Albsig ka nisur në Durrës dhe ka përfunduar në Sarandë.

Përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Albsig në bashkëpunim me drejtorët e Degëve të Albsig nëpër rrethe morën nismën për sensibilizimin e pushuesve që të bëjnë sigurimet e duhura në Albsig.



Fushata kishte për qëllim aktivizimin e qytetarëve në nivel lokal që të ndikojnë në sensibilizimin e komunitetit vendas për rëndësinë e sigurimeve në vend. Ndryshe nga herët e tjera, grupi i Marketingut të Albsig ka qenë prezent në çdo çadër të pushuesve përveçse për t'ju dhuruar artikujt promocionalë për t'ju shpjeguar atyre rëndësinë e sigurimeve.

Njëkohësisht grupi i Marketingut beri të mundur sensibilizimin e konsumatorëve për sigurimet ku, sipas tyre sigurimet, jo vetëm që mbrojnë financat personale të gjithësecilit prej nesh, por dhe të çdo familjeje shqiptare.

Përfaqësuesit e Drejtorisë së Albsig theksuan se fushata të tilla bëhen për të sensibilizuar, jo vetëm pushuesit nëpër bregdet, por edhe emigrantët e ardhur në atdhe, pasi një pjesë e mirë e tyre ndikojnë shumë në mentalitetin e zonës ku ata banojnë.







## Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë, Hap Dyert Këtë Vit

**Grupi KASTRATI sjell në Shqipëri përvojën gjermane të arsimit dual profesional**

Edhe shkollë edhe punë. Tashmë vetëm në Kolegjin Profesional Gjerman të Teknologjisë mund të përfitosh nga kjo përvojë. Për herë të parë të rinjtë do të kenë mundësi të praktikohen direkt në fushat që ato kanë përzgjedhur për t'u perfeksionuar. Tashmë, kanë startuar regjistrimet për në Kolegjin Profesional Gjerman të Teknologjisë, i cili do të përgatisë profesionistë të kualifikuar të Teknologjisë së Automobilëve, Elektromekanikës, Elektronikës, Menaxhimit të Ndërtimit, Elektrikës si dhe të Sistemeve të Ajrit të Kondicionuar. Kolegji Profesional Gjerman, është nismë e Grupit KASTRATI si përgjigje e nevojës tepër të madhe të tregut të punësimit për profesionistë të kualifikuar dhe me përvojë pune në fushën e teknologjisë. Risia e këtij kolegji profesional është metoda e arsimit dual; ndërthurja e teorisë me praktikën; gjë e cila garanton punësim të menjëhershëm pas përfundimit të shkollës. Përfitimet e studimit në këtë kolegji nuk mbarojnë me kaq. Bizneset e Grupit KASTRATI venë në dispozicion hapësirën dhe mjetet e nevojshme për praktikën e studentëve dhe janë të parët që do të mirëpresin të diplomuarit duke iu ofruar punë në kompanitë e tyre.

Modeli gjerman i arsimit profesional tregon se tranzicionet më të mira dhe pa probleme ndodhin kur punëdhënësit janë të përfshirë në hartimin e kurseve profesionale dhe ku mësimi teorik në shkolla kombinohet me përvojën e punës praktike në formën e saj mësimore. Gjermania renditet e para në Evropë për sa i përket inovacionit në ekonomi, industri e më gjerë dhe Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë sjell në Shqipëri pikërisht atë metodë arsimore që ka kaluar me shumë sukses provat e ekonomisë globale. Vendet me një integrim më të lartë mes shkollës dhe punës, shfaqin një tranzicion më të butë dhe më të shpejtë për të rinjtë. Kjo arrihet përmes programeve të praktikës ose përmes numrit më të madh të të rinjve që kombinonë efektivisht shkollën dhe përvojat e hershme në tregun e punës.

### **Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë, shpresë për të ardhmen e të rinjve.**

Profesionet e ëndërruara për të rinjtë tashmë do të bëhen realitet vetëm duke u bërë pjesë e Kolegjit Profesional Gjerman të Teknologjisë. Jo vetëm kaq, por Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë synon që kompanitë e vogla dhe të mesme të përfitojnë teknikë të mirëkualifikuar, me përvojë të pasur, që janë fleksibël dhe më të adoptueshëm në sfidat e reja ekonomike dhe që reagojnë pozitivisht ndaj ndryshimeve të tregut në Shqipëri. Kolegji më i ri profesional në Shqipëri do të ofrojë programe një dhe dy vjeçare studimesh, si dhe kurse trajnimi me afate 3-6 muaj. Programi mësimor do të përmbajë praktika profesionale të garantuara në biznese me standarde evropiane si Auto Star Albania, përfaqësuese e Mercedes-Benz në Shqipëri, si dhe ndërmarrje me standartet më të larta të Fushës së Ndërtimit dhe Teknologjisë së Informacionit, pjesë të Grupit KASTRATI. Shkolla ofron mësimin me pedagogë dhe ekspertë nga Gjermania, Zvicra, Austria, etj, të cilët do të përdorin kurrikula të përditësuara sipas standardeve evropiane.

**Për më shumë informacion mbi kolegjin dhe mënyrën e aplikimit, mund të vizitoni:**

 [www.kpgjt.edu.al](http://www.kpgjt.edu.al)

 [info@kpgjt.edu.al](mailto:info@kpgjt.edu.al)

 +355 69 60 99 099

### **Pse ju duhet të jeni pjesë e Kolegjit?**

Rëndësia e shkollave të tilla profesionale në vendin tonë është tepër e madhe, pasi ndihet një mungesë e theksuar e fuqisë punëtore me aftësi profesionale teknike ndërkohë që bizneset shqiptare synojnë të arrijnë nivelet dhe standardet bashkëkohore. Për më tepër, edhe vetë kompanitë kanë dëshirë të trajnojnë dhe zhvillojnë aftësitë e stafit të tyre, por mungesa e bashkëpunimit, e informacionit dhe pamundësia e përballimit të kostove ka bërë që një praktikë e tillë të mos ekzistojë thuajse fare.



Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë, përveç përgatitjes së një stafi të kualifikuar teknik, do t'i vijë në ndihmë edhe kompanive të tjera në vend që do të kenë dëshirë për të trajnuar dhe aftësuar stafin e tyre, duke nxitur frymën e bashkëpunimit dhe duke dhënë kontribut domethënës në zhvillimin profesional të vendit. Kolegji Profesional Gjerman i Teknologjisë, është tashmë në proces akreditimi dhe do të ofrojë programe studimi të mbështetura në përvojën dhe praktikën me të mira të vendeve evropiane dhe sipas kritereve të sistemit të Bolonjës, të vlerësuara me ECTS.

Studentët e këtij kolegji do të kenë në dispozicion teknologjinë më të fundit në të gjitha fushat ku do të përgatiten, me laboratorë mësimorë, si dhe me praktikën në terren në disa prej bizneseve më të suksesshme në Shqipëri. Nisma e Grupit KASTRATI për hapjen e një shkolle të tillë profesionale ka ardhur nga bindja se sistemi i bashkëpunimit me bizneset, i futjes së tyre në shkolla dhe lidhja e studentëve me vendin e mundshëm të punës, është çelësi i gjithë ndryshimit; si për studentët që dëshirojnë të kenë garanci punësimi, ashtu edhe për bizneset që kërkojnë profesionistë të nivelit të lartë.

### **S'ka teori pa praktikë dhe s'ka praktikë pa teori!**

Kjo është motoja e Kolegjit Profesional Gjerman të Teknologjisë, i cili do të nisë shumë shpejt të përgatisë profesionistët e së ardhmes.





☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ [info@albsig.al](mailto:info@albsig.al)

---

[WWW.ALBSIG.AL](http://WWW.ALBSIG.AL)